

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5536
E enjte, 26 korrik 2018
çmimi 0.40 €

Presidentët Clinton dhe Bush ia mbajtën fjalën Ekrem Bardhës për Kosovën

FAQE 12-13



Shkruan: Ferdinand SAMARXHI,
Fitues i Antenës së Artë / Mjeshtër i Madh

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com




facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", FATMIR XHELILI ■ FAQE 4-5

Task Forca t'i parandalojë aksidentet në komunikacion

Anëtari i Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, Fatmir Xhelili, ka thënë se mospatrullimi i mjaftueshëm nëpër rrugë, mungesa e kontrolleve teknike rigorozë për gjendjen e veturave, tejkalimi i shpejtësisë si dhe përdorimi i alkoolit janë faktorët kryesorë për numrin e madh të aksidenteve dhe viktimave në komunikacion. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se Task Forca e sapokrijuar duhet t'i parandalojë aksidentet me fatalitet, duke qenë serioze ndaj atyre që i shkelin rregullat e komunikacionit. Xhelili ka bërë thirrje për prani më të madhe të pjesëtarëve të policisë nëpër rrugë si dhe prani të numrit më të madh të patrullave nëpër qytete në mënyrë që këto të kenë efekt në parandalimin e aksidenteve në komunikacion



© Gazmend Ademaj

ZYRTARËT QE VERITARË DHE ATA POLICORË VIZITUAN
PIKËKALIMIN KUFITAR NË MERDARE

Kolonat në pikëkalimin në Merdare po krijohen nga pala serbe



Ministri i Punëve të Brendshme, Bejtush Gashi, i shoqëruar edhe nga drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Naim Rexha, ka vizituar të mërkurën pikëkalimin kufitar në Merdare për të parë nga afër se si po zhvillohen punimet aty. Ai ka thënë se kolonat në këtë pikëkalim vijnë si rezultat i palës serbe e cila nuk po i respekton marrëveshjet e Brukselit, ndërsa ka bërë me dije se probleme te pala e Kosovës nuk ka ■ FAQE 3

Lëvizja Vetëvendosje kërkon ridraftimin e Projektligjit për pagat

Përfaqësuesit e Lëvizjes Vetëvendosje, Besnik Bislimi dhe Arbërie Nagavci, në një konferencë për medie kanë kërkuar të mërkurën që të ridraftohet Projektligji për pagat. Ata kanë thënë se kjo Qeveri ia ka rritur paligjshëm pagat vetes duke hartuar një projektligj që nuk i rregullon aspak problemet e pagave në sektorin publik ■ FAQE 3



AKTUALE

**PACOLLI: NUK KEMI ASNJË
NOTË VERBALE SE NDONJË
SHTET KA TËRHEQUR
NJOHJEN** F. 2

**PROJEKTILIGJI PËR MËSIMD-
HËNËSIT E VITEVE '90 NUK
PROCEDOHET NË KUVEND** F. 6

**GASHI THOTË SE MINISTRIA E
DIASPORËS NUK KA BUXHET
TË PAMJAFTUESHËM** F. 6

**NGORDHIN PESHQIT NË LUMIN
MIRUSHA, SHKAQET NUK
DIHEN** F. 10

EKONOMI

**MEHMETI: BQK-JA KA
RUAJTUR OBJEKTIVIN
E STABILITETIT FINANCIAR
NË VEND** F. 8

**MPMS-JA LANSO
NËN GRANTET PËR 27
ORGANIZATA JOQEVERITARE
LOKALE** F. 8

SPORT

**LIRIA DHE DRENICA NË
AKSION** F. 16

**DRITA NË LUKSEMBURG,
SOT PËRBALLET ME
DUDELANGEN** F. 16

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.PK.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel&Fax: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegijibiznesi.com
info@kolegijibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Maqedonia nis bisedimet e paraanëtarësimit në NATO

SHKUP, 25 KORRIK - Maqedonia nisi të mërkurën formalisht bisedimet e anëtarësimit në NATO, pasi më 12 korrik mori ftesën. Në Shkup arriti një delegacion i NATO-s, i udhëhequr nga drejtori për çështje evropiane dhe globale, James McKee, i cili me institucionet e Maqedonisë do të bisedojë për çështje politike, të sigurisë, të mbrojtjes dhe financiare, në kuadër të

negociatave për anëtarësim. Në konferencën e përbashkët për media me koordinatorin kombëtar të Maqedonisë për anëtarësimin në NATO, Stevo Pendarovski, McKee shfaqti shpresën se Maqedonia, përafërsisht për një vit e gjysmë, do të bëhet anëtarja e 30 e NATO-s. "Marrë parasysh përvojat e mëparshme, i gjithë procesi duhet

të zgjasë rreth 18 muaj", tha McKee.

Dyert e Maqedonisë në NATO ia ka hapur arritja e marrëveshjes me Greqinë për çështjen e emrit. Megjithatë, anëtarësimi i Maqedonisë në këtë mekanizëm kushtëzohet me zbatimin e plotë të Marrëveshjes me Greqinë, metë cilën emri i saj ndryshon në Maqedonia e Veriut.



Pacolli: Nuk kemi asnjë notë verbale se ndonjë shtet ka tërhequr njohjen

Zëvendëskryeministri, njëherësh ministër i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, ka thënë se Serbia është duke shpenzuar shumë kohë, shumë mjete, shumë njerëz në botë, duke tentuar ta pengojë Kosovën, integritet e Kosovës, njohjet e Kosovës, kultivimin e marrëdhënieve të mira me shtetet e tjera



PRISHTINË, 25 KORRIK - Zëvendëskryeministri, njëherësh ministër i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë" ka thënë se deri më tash Kosova nuk ka asnjë notë verbale se ndonjë shtet ka tërhequr njohjen. Ai thotë se Serbia është duke shpenzuar shumë e gjithçka për pengimin e Kosovës për anëtarësim në mekanizma ndërkombëtarë. "Shikoni, ne nuk kemi marrë asnjë notë verbale prej asnjë shteti në botë, ku një shtet në njëfarë mënyre e vë në dyshim mosnjohjen e Kosovës. Normalisht shtetet

që e kanë njohur Kosovën, e kanë njohur me notë verbale, nota verbale është drejtuar në institucionet e Kosovës dhe si e tillë ka hapur kapitullin e marrëdhënieve të mira të Kosovës me shtetin përkatës. Nëse ndryshon diçka në këtë rrafsh, i njëjti shtet duhet t'ia drejtojë Kosovës një notë verbale dhe t'i thotë se nga sot ne juve nuk ju njohim, do të thotë ndryshon pozitën, qasjen me ju, edhe pse një gjë e tillë nuk është diplomatike, nuk njihet fare një veprim i tillë, pasi që një shtet nuk ka nevojë t'i thotë shtetit tjetër që duhet të kemi marrëdhënie të mira ose jo. Ai nëse dëshiro

ron vetëm pushon që të ketë marrëdhënie të mira, por nuk thuhet ajo. Dhe një notë të tillë verbale ose një copë letër prej asnjë shteti nuk e kemi marrë", ka thënë Pacolli. Ai ka theksuar se Serbia është duke shpenzuar shumë kohë, shumë mjete, shumë njerëz në botë, duke tentuar ta pengojë Kosovën, inte

grimet e Kosovës, njohjet e Kosovës, kultivimin e marrëdhënieve të mira me shtetet e tjera. Zëvendëskryeministri Pacolli në këtë intervistë ka folur edhe për dialogun Kosovë - Serbi dhe arritjen e një marrëveshjeje të mundshme. "Duke shikuar kohën në të cilën jemi duke jetuar, ku gjërat

ndodhin shpejt, praktikisht unë e shoh se një marrëveshje, një paqe me Serbinë, është shumë e nevojshme, për arsye se gjeneratat e reja, një numër i madh i tyre edhe në Serbi, edhe këtu në Kosovë, të cilët kanë lindur pas konfliktit, nuk duan ta trashëgojnë barrën e së kaluarës", ka thënë Pacolli.

Gjonaj: Vetingu po pastron drejtësinë, nuk ka kthim pas

TI Ranë, 25 KORRIK - "Vetingu po rikthen shpresën e qytetarëve se edhe në Shqipëri mund të ketë drejtësi dhe sa më shumë shtohen shembujt që ushqejnë shpresën, aq më shumë shtohen edhe fletërrufetë e dëshpëruara të opozitës kundër Vetingut", deklaroi ministrja shqiptare e Drejtësisë, Etilda Gjonaj. Në një konferencë me gazetarë, Gjonaj u shpreh se "procesi i

Vetingut po qëllohet përditë me gurët e revanshit të dëshpëruar të një opozite që pasi ka humbur pushtetin absolut mbi gjyqësorin e korruptuar deri në palcë, ka humbur edhe rrugën e arsyes". Ajo shton se vetingu po funksionon dhe pastrimi i shumëpritur prej dekadash i Pallatit të Drejtësisë po ndodh. Në reagim të qëndrimeve të opozitës, Gjonaj tha se "që opozi

ta nuk e donte Vetingun kjo dihet botërisht. Që opozita votoi me pahir edhe Reformën në Drejtësi, edhe Vetingun, edhe përfshirjen e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit në Kushtetute, edhe kjo dihet botërisht. Që opozita sot kërkon me dëshpërim rishikimin (dmth. shkatërrimin) e këtij kuadri ligjor të konsideruar botërisht si një revolucion në sistemin e drejtësisë shqiptare, edhe



kjo është përditë e më e qartë". Por po ashtu, tha ajo, për këdo që kërkon shtet të së drejtës për gati

tashmë tri dekada, në këtë vend me një sistem drejtësie të kapur nga politika dhe të kalbur nga korrupsioni, është e qartë se kthim mbrapa nuk mund të ketë. "Shantazhet e vazhdueshme, kërcënimet e përditshme, bllokimet e imagjinuara si mundësi për ta imponuar kthimin mbrapa, nuk kanë asnjë mundësi të funksionojnë", theksoi Gjonaj.

PD: Shqipëria është një vend jo mikpritës për bizneset e huaja

Tiranë, 25 korrik - Partia Demokratike ka komentuar deklaratën e Departamentit Amerikan të Shtetit, i cili e cilëson Shqipërinë vend të pasigurt për investime. Në një deklaratë për shtyp, deputetja e PD-së, Jorida Tabaku, tha se ky nuk është një lajm i mirë për Qeverinë. Sipas saj, vendi drejtohet nga oligarkët.

"Vendimi i Departamentit Amerikan nuk është lajm i mirë për Qeverinë. Vendi drejtohet nga oligarkët. Shqipëria është një vend jo mikpritës për bizneset e huaja. Opozita e ka denoncuar me kohë këtë sjellje të Qeverisë. Rama sulmoi kreun e dhomës amerikane. Sot marrin tenderë vetëm njerëz të Ramës. Shqipëria

nuk mund të jetë më vendi ku oligarkët marrin çdo koncesion", tha deputetja e PD-së, Jorida Tabaku. "Të mos jesh vend mikpritës për bizneset amerikane do të thotë se në Shqipëri ka klimë armiqësore ndaj tyre me taksa të larta, konkurrencë të pandershme nga paratë e pista të trafikut të drogës dhe korrupsionit, ka përqendrim

të ekonomisë tek një grusht oligarkësh dhe klientësh të Edi Ramës. Vendimi i Departamentit Amerikan të Shtetit për të mos e konsideruar Shqipërinë si një vend miqësor për bizneset amerikane nuk është një rufe në qiellin e hapur të një vendi të qeverisur nga narkotrafikantët dhe oligarkët", tha Tabaku.



Zyrtarët qeveritarë dhe ata policorë vizituan pikëkalimin kufitar në Merdare

Kolonat në pikëkalimin në Merdare po krijohen nga pala serbe

Ministri i Punëve të Brendshme, Bejtush Gashi, i shoqëruar edhe nga drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Naim Rexha, ka vizituar të mërkurën pikëkalimin kufitar në Merdare, për të parë nga afër se si po zhvillohen punimet aty. Ai ka thënë se kolonat në këtë pikëkalim vijnë si rezultat i palës serbe e cila nuk po i respekton marrëveshjet e Brukselit, ndërsa ka bërë me dije se probleme tek pala e Kosovës nuk ka.



Bejtush Gashi dhe drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Naim Rexha, janë takuar edhe me kryetarin e Komunës së Podujevës, Agim Velu.

Në këtë takim ministri Gashi dhe kryetari Velu kanë biseduar për çështjet që e shqetësojnë këtë komunë, ndërsa theks të veçantë i kanë dhënë çështjes së rendit dhe sigurisë për qytetarët e Podujevës dhe shqetësimin për numrin e madh të aksidenteve që po ndodhin në rrugët e këtij rajoni dhe përkrahjen krijimin e "Task Forcës" për siguri në komunikacion. Gjithashtu, u bisedua për rolin dhe angazhimin e policisë për mbrojtjen e pronës publike dhe private, veçmas për mbrojtjen e pyjeve nga prerësit ilegalë.

Ministri Gashi diskutoi edhe për Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi të kësaj komune, ku tha se është shumë me rëndësi që ky Këshill të mbahet funksional në mënyrë që të adresohen të gjitha

shqetësimet e qytetarëve. "Sot realizuam një vizitë në Komunën e Podujevës, me qëllim që të informohemi për zhvillimet që komuna përballet dhe angazhimet që

janë marrë shtesë në kuadër të komunës për t'u mobilizuar në ditët e verës. Ky mobilizim vjen si nevojë e shtimit të fluksit të bashkatdhetarëve tanë që jetojnë

në Perëndim, dhe në këtë drejtim komuna është zotuar që kanë marrë angazhime shtesë për t'i plotësuar kërkesat që kanë qytetarët", ka thënë ministri Gashi.

**EPOKA
ERE**

Arbisa SHEFKIU

PODUJEVË, 25 KORRIK - Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme, Bejtush Gashi, i shoqëruar edhe nga ushtruesi i detyrës së drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Kosovës, Naim Rexha, kanë vizituar të mërkurën pikëkalimin kufitar në Merdare, për të parë nga afër se si po zhvillohen punimet aty. Ministri Gashi ka shprehur mirënjohjen për UNOPS-in për punën e vazhdueshme që është duke e bërë në këtë pikëkalim, si një nga pikat më të frekuentuara momentalisht. Ai ka thënë se kolonat në këtë pikëkalim vijnë si rezultat i palës serbe e cila nuk po i respekton marrëveshjet e Brukselit, ndërsa ka bërë me dije se probleme tek pala e Kosovës nuk ka. Sipas ministrit Gashi, në pikën e kontrollit të Kosovës pritet për një veturë zgjasin 3 deri në 5 minuta.

Ministri i Punëve të Brendshme,

Lëvizja Vetëvendosje kërkon ridraftimin e Projektligjit për pagat

PRISHTINË, 25 KORRIK (ER) - Përfaqësuesit e Lëvizjes Vetëvendosje, Besnik Bislimi dhe Arbërie Nagavci, në një konferencë për medie kanë kërkuar të mërkurën që të ridraftohet Projektligji për pagat. Ata kanë thënë se kjo Qeveri ka rritur paligjshëm pagat vetes duke hartuar një projektligj që nuk i rregullon aspak problemet me pagat e sektorit publik. Sipas tyre, një nga problemet kryesore në sektorin publik në Kosovë është kaosi me pagat e të punësuarve, pabarazia në paga për pozita ekuivalente, jotransparenca gjatë klasifikimit të pozitave dhe diskriminimi për kategori të caktuara.

Nënkryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Besnik Bislimi, ka thënë se kjo parti konsideron që projektligji ka nevojë për ridraftim komplet të projektligjit në mënyrë që versioni final i tij t'i shmangë gjithë anomalitë e

evidentuara në versionin e tanishëm. Edhe deputetja e kësaj lëvizje, Arbërie Nagavci, ka thënë se ky projektligj ka shumë të meta, paqartësi dhe gabime logjike. Ajo ka theksuar se ky projektligj është duke e bërë konfuze çështjen e mëditjeve dhe të pagave. "Të gjitha problemet dhe mangësitë e kësaj fushe, Qeveria e Kosovës synon t'i mënjanojë përmes projektligjit për paga, një dokument prej 11 faqesh. Në vend të një dokumenti profesional që do t'i adresonte këto probleme të lidhura me kompensimin e të punësuarve në sektorin publik, Qeveria ka draftuar një projektligj krejtësisht të pastrukturuar, plot e përplot paqartësi, gabime logjike e përmbytjesore, definicione gjysmake ose të pakuptimta, duke shtuar konfuzitetin e deritanishëm në sferën e pagave dhe mëditjeve për sektorin publik", ka thënë deputetja Nagavci.



Flet për "Epokën e re", Fatmir Xhelili

Task Forca t'i parandalojë a

Anëtari i Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, Fatmir Xhelili, ka thënë se mospatrullimi i mjaftueshëm nëpër rrugë, mungesa e kontrolleve teknike rigoroze për gjendjen e veturave, tejkalimi i shpejtësisë si dhe përdorimi i alkoolit janë faktorët kryesorë për numrin e madh të aksidenteve dhe viktimave në komunikacion. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se Task Forca e sapokrijuar duhet t'i parandalojë aksidentet me fatalitet, duke qenë serioze ndaj atyre që i shkelin rregullat e komunikacionit. Xhelili ka bërë thirrje për prani më të madhe të pjesëtarëve të policisë nëpër rrugë si dhe prani të numrit më të madh të patrullave nëpër qytete në mënyrë që këto të kenë efekt në parandalimin e aksidenteve në komunikacion

EPOKA
ERE

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 25 KORRIK - Anëtari i Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, deputeti nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Fatmir Xhelili, ka thënë të mërkurën se gjendja e sigurisë në vendin tonë është e qetë dhe pa probleme të mëdha. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka theksuar se Kosova ka bashkëpunim të mirë me Shqipërinë, Maqedoninë dhe me Malin e Zi. Sipas tij, ky bashkëpunim është dëshmuar gjatë operacioneve të përbashkëta që janë zhvilluar për t'i evituar disa rreziqe. Xhelili ka pohuar se është nevojë dhe domosdoshmëri për Policinë e Kosovës dhe atë të Serbisë që të kenë bashkëpunim në mes vete për t'i evituar rreziqet eventuale në të dy shtetet. Duke folur për procesin e anëtarësimit të Kosovës në organizata ndërkombëtare, ai ka thënë se lobimi është pozitiv dhe këtë vit ka gjasë që Kosova të bëhet pjesë e Interpolit. Xhelili ka vlerësuar se Kosova i ka plotësuar kriteret teknike për të qenë pjesë e Interpoli. Ndërsa sa i përket numrit të madh të aksidenteve me fatalitet në komunikacion, ai ka bërë me dije se një gjë e tillë po ndodh për shkak të mospatrullimit të mjaftueshëm nëpër rrugë, mungesës së kontrolleve teknike rigoroze për gjendjen e veturave, tejkalimit të shpejtësisë si dhe përdorimit të alkoolit. Xhelili ka thënë se Task Forca e sapo krijuar duhet t'i parandalojë aksidentet me fatalitet duke qenë serioze ndaj atyre që i shkelin rregullat e komunikacionit.

Ai ka shprehur optimizëm se masat ndëshkuese dhe parandaluese do të ndikojnë pozitivisht në uljen e numrit të fatkeqësive dhe aksidenteve në komunikacion. Sipas Xhelilit, masat parandaluese, këshillat si dhe prania e policëve në uniformë dhe patrullave në rrugë ndikon më shumë sesa gjrobat.

"Epoka e re": Z. Xhelili, si e vlerësoni situatën e sigurisë dhe sa janë të sigurt qytetarët në shtetin e Republikës së Kosovës?
Xhelili: Gjendja e sigurisë në vendin tonë është e qetë dhe pa probleme të mëdha. Situata është nën kontroll, qytetarët e ndiejnë vetën të sigurt, prandaj jetojnë, punojnë dhe veprojnë pa frikë për ndonjë rrezikim. Organet tona të rendit kanë identifikuar ato që njihen si rreziqe për Kosovën dhe besoj se efikasiteti, funksionaliteti dhe cilësia e punës së policisë është në nivel për të pasur situatën nën kontroll, por edhe prania e KFOR-it bën që qytetarët e Kosovës të ndihen të sigurt. Realisht nuk ka hapësirë për të pasur frikë. Kurse sa i përket eventualisht ndonjë veprimi apo akti të vijave ekstreme nga të cilat frikësohen pothuajse të gjithë qytetarët evropianë, nuk besoj se në Kosovë do të realizohet ndonjë akt i tillë. Organet tona të sigurisë kanë treguar se janë efikase në luftimin e kësaj dukurie negative.

"Epoka e re": Në këtë drejtim, si e shihni bashkëpunimin e organeve të rendit me organet e vendeve të tjera në rajon?
Xhelili: Bashkëpunimi ekziston sidomos me Shqipërinë, Maqedoninë dhe me Malin e Zi. Ky bashkëpunim është në nivel dhe këtë e kanë dëshmuar



Aksidentet në komunikacion



operacionet e përbashkëta që janë zhvilluar për t'i evituar disa rreziqe siç ka qenë rasti në Shkodër apo paralajmërimi për rastin në Mal të Zi. Kurse bashkëpunimi me organet e rendit të Serbisë është bërë në mënyrë indirekte deri tash me EULEX-in, por shpresoj se tash do të gjendet ndonjë formë që dalëngadalë të kalohet në një bashkëpunim drejtpërdrejt siç ka qenë rasti i Oliver Ivanoviqit. Është nevojë dhe domosdoshmëri edhe e Policisë së Kosovës, edhe e Policisë së Serbisë, për të pasur një bashkëpunim mes vete për t'i evituar rreziqet eventuale në të dyja shtetet.

"Epoka e re": Pavarësisht prej përpjekjeve, Kosova edhe më tutje nuk ka arritur të bëhet pjesë e organizatave të sigurisë. Si e shihni ecurinë e këtij procesi dhe sa ka gjasa që këtë vit vendi ynë të bëhet pjesë e Interpolit?

Xhelili: Besoj se Kosova i plotëson kriteret teknike për të qenë pjesë e Interpolit, por janë kriteret politike, faktikisht është shtetësia e papranuar në Kombet e Bashkuara. Mirëpo lobimi është shumë pozitiv në kohët e fundit dhe shpresoj se kjo do të realizohet. Nuk kam dëshirë të dal me prononcime se kur do të ndodhë kjo saktësisht, por shpresoj se Kosova do të bëhet anëtare e Interpolit.

"Epoka e re": Mund të presim lëvizje pozitive edhe në organizata të tjera ndërkombëtare siç është Evropoli?

Xhelili: Anëtarësimi i Kosovës në organizata ndërkombëtare është zinxhiror. Edhe në Europol çështja është problematike dhe besoj se bisedimet me Serbinë dhe përfundimit i tyre i determinojnë gjërat. Megjithatë, bisedimet pritet të shkojnë më shpejt sesa që i paramendojnë njerëzit.

"Epoka e re": Në ditët, javët dhe muajt e fundit ka pasur një numër të madh të aksidenteve me fatalitet në komunikacion, me ç'rast Policia e Kosovës ka krijuar një Task Forcë. Besoni se do të ketë sukses në parandalimin dhe uljen e numrit të aksidenteve dhe viktimave në komunikacion?

Xhelili: Varet se sa serioze do të jetë qasja e Task Forcës ndaj atyre që i shkelin rregullat e komunikacionit. Ka shumë arsye për numrin e madh të viktimave në trafik. Mospatrullimi i mjaftueshëm nëpër rrugë, mungesa e kontrolleve teknike rigoroze për gjendjen e veturave

në komunikacion, tejkalimi i shpejtësisë në vendet ku nuk është i lejuar, si dhe përdorimi i alkoolit nëpër ahengje të ndryshme janë faktorët që kanë ndikuar në zvogëlimin e kujdesit, ku për pasojë ka numër të madh të aksidenteve dhe viktimave në komunikacion. Shpresoj se masat ndëshkuese dhe parandaluese do të ndikojnë pozitivisht në uljen e numrit të fatkeqësive dhe aksidenteve në komunikacion.

"Epoka": Është bërë me vonesë kjo Task Forcë?

Xhelili: Nuk jam adhures i task forcave, sepse konsideroj se policia e trafikut rrugor duhet t'i marrë parasysh obligimet që i ka për zbatimin e ligjit në rrugë, duke vepruar në mënyrë parandaluese dhe ndëshkuese. Ndoshta ka qenë jopopullore

masa për marrjen e një dokumenti, gjegjësisht patentshoferit në rastin e shqiptimit të dënimeve, mirëpo në ambientin dhe kulturën tonë të ngasjes në trafik është treguar e suksesshme ani pse është jopopullore. Shpresoj se qytetarët do t'i binden policisë sepse duhet ta respektojnë uniformën dhe ligjet në fuqi. Me keqardhje po them por, ndoshta, fatkeqësitë që kanë ndodhur në këtë periudhë kohore janë edhe një shenjë alarmi për rreziqet eventuale për të gjithë pjesëmarrësit në komunikacion. Shoferët duhet të vetëdijeshohen dhe të jenë më të kujdesshëm gjatë ngasjes.

"Epoka e re": As rritja e gjobave nuk ka pasur efekt në disiplinimin e shoferëve?

Xhelili: Ka pasur rritje të numrit të shqiptimit të gjobave, por

pagesat kanë rënë shumë. Domethënë, prej 60 përqindësh sa janë paguar me kohë, kanë rënë pesë për qind. Kështu që, mbetem ithtar që masat parandaluese, këshillat si dhe prania e policëve në uniformë dhe patrullave në rrugë është më ndikuese sesa gjobat.

"Epoka e re": Është dashur të ketë një fushatë më të madhe vetëdijesuese nga institucionet përkatëse?

Xhelili: Policia ka pasur mjaft aktivitete propaganduese në këtë drejtim, por personalisht mendoj se kujdesi duhet të jetë më i madh. Prania sa më e madhe e pjesëtarëve të policisë nëpër rrugë si dhe prania e numrit më të madh të patrullave nëpër qytete do të ketë efekt në parandalimin e aksidenteve në komunikacion.

Kurti, ambasadorit të Francës: Dialogu matet me Mitrovicën

PRISHTINË, 25 KORRIK (ER) - Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka pritur të mërkurën në takim ambasadorin e Francës në Kosovë, Didier Chabert, me të cilin ka biseduar për zhvillimet aktuale në vend me theks të veçantë mbi dialogun Kosovë - Serbi. Në këtë takim Kurti ka paraqitur edhe një herë qëndrimin e

Vetëvendosjes karshi dialogut të filluar nga presidenti i Kosovës që, sipas tij, është pa mandat nga Kuvendi. "Ne fillimisht duhet ta shqyrtojmë dialogun gjashtëvjeçar paraprak që ta dimë se çfarë u bë dhe ku jemi. Pastaj të përgatitemi mirë: të formulojmë bashkërisht në Kuvend qëllimet tona dhe kërkesat ndaj Serbisë, dhe të merremi

vesh për parimet dhe kornizën e dialogut të ri. Ndërkaq, ekipi negociator me strategji e udhëheqës të vetin vjen vetëm më pas", ka thënë Kurti, duke theksuar se "çdo dialog e marrëveshje matet në Mitrovicë". Kurti dhe ambasadori francez kanë shprehur interesimin për kontakte dhe takime të vazhdueshme.




Haradinaj kërkon përkrahjen e Dacit për dialogun me Serbinë

PRISHTINË, 25 KORRIK (ER) - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka pritur të mërkurën në takim kryetarin e Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, Nexhat Daci, me të cilin ka biseduar rreth zhvillimeve aktuale në Kosovë dhe rajon. Kryeministri Haradinaj rast e ka njoftuar akademik Dacin për angazhimet e Qeverisë së Kosovës në proceset në të cilat është duke kaluar Kosova, me theks të veçantë në

rrugën e integritimeve euroatlantike dhe procesin e dialogut me Serbinë. Kryeministri Haradinaj ka kërkuar nga akademik Daci që në proceset e rëndësishme nëpër të cilat po kalon Republika e Kosovës, të përfshihet edhe më shumë Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, kontributi i së cilës do të ishte shumë i rëndësishëm. "Kontributi dhe roli juaj dhe i institucionit të cilin e drejtoni do të ishte i rëndësishëm për

vendin, pasi jemi në një situatë mjaft delikate dhe duke u përballur me përcaktimin e shumë çështjeve të cilat janë jetike për të tashmen dhe të ardhmen e vendit tonë", ka thënë kryeministri Haradinaj.

Ndërkaq kryetari i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, Nexhat Daci, tha se institucioni të cilin e udhëheq do ta ofrojë kontributin e vet dhe përkrahjen e gjithanshme për vendin.



Projektligji për mësimdhënësit e viteve '90 nuk procedohet në Kuvend

Në mungesë të kuorumit, Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sporte Inovacion dhe Ndërmarrësi nuk ka arritur ta procedojë të mërkurën për në Kuvend Projektligjin për mësimdhënësit e viteve '90

**EPOKA E RE****Arbisa SHEFKIU**

PRISHTINË, 25 KORRIK - Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sporte, Inovacion dhe Ndërmarrësi ka mbajtur të mërkurën mbledhjen e rregullt, të kryesuar nga Ismajl Kurteshi, kryetar, në të cilën ka proceduar Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Komisionit Evropian dhe Kosovës mbi pjesëmarrjen e Kosovës në "ERASMUS+", Programin e Unionit për Arsim, Trajnim, Rini dhe Sport, si dhe është diskutuar lidhur me Projektligjin për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës të vitit shkollor 90/91 deri në vitin shkollor 98/99.

Anëtarët e Komisionit e proceduan për në Kuvend Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes

ndërmjet Komisionit Evropian dhe Kosovës mbi pjesëmarrjen e Kosovës në "ERASMUS +", Programin e Unionit për Arsim, Trajnim, Rini dhe Sport, i cili do t'i propozohet Kuvendit që të votohet në mënyrë të përshtetshme, me qëllim që të përfshihen të gjithë studentët e universiteteve të Republikës së Kosovës. Në këtë mbledhje, për t'i paraqitur sugjerimet dhe rekomandimet e tyre, të ftuar ishin edhe dy përfaqësuesit e ministrive përkatëse, ai i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, si dhe përfaqësuesja e Ministrisë së Financave. Përfaqësuesi i MASHT-it, Alush Istogu, ka thënë se janë vonuar për këtë projektligj, ndërkaq çështja e koston buxhetore, sipas tij, është obligative. Po ashtu, Istogu ka shtruar nevojën e një planifikimi buxhetor nga Ministria e Punës dhe

Mirëqenies Sociale. Përfaqësuesja e Ministrisë së Financave, Mevlyde Shamolli, ka folur për implikimet buxhetore që përbën ky projektligj. Shamolli ka thënë se është bërë debat i gjerë lidhur me vlerësimin financiar, duke vënë në pah se ky ligj ka kosto të lartë

buxhetore. Ajo ka theksuar se parashikimet e Ministrisë së Financave janë brenda kornizës ligjore, ndërkaq implikimet buxhetore janë jashtë kornizave ligjore.

Në fund të takimit, Shamolli ka bërë me dije se nuk mund t'u japë të drejtë dhjetë mijë për-

fituesve që të kategorizohen ngaqë, siç ka thënë ajo, ende nuk është specifikuar numri i saktë i mësimdhënësve që kanë përvojë dhjetëvjeçare. Sipas saj, është dëshmuar që pensioni prej 240 eurosh do ta fusë shtetin në minus. Në mungesë kuorumi, projektligji nuk është votuar.

Nënshkruhet marrëveshja në mes të MPB-së dhe AMRKS

Qëllimi i kësaj marrëveshje të bashkëpunimit është të sigurojë bashkëpunim të vazhdueshëm midis Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Asociacionit Kosovar të Motorizimit nëpërmjet koordinimit institucional të aktiviteteve për sigurinë në rrugë, rrjedhimisht me qëllim të rritjes së sigurisë për të gjithë pjesëmarrësit në trafik



përveç informacioneve për qytetarët lidhur me trafikun në rrugët e vendit, të ofrojë edhe

asistencë dhe ndihmë teknike në rrugë për të gjithë pjesëmarrësit në trafik.

EPOKA E RE**Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 25 KORRIK - Ministria e Punëve të Brendshme dhe Asociacioni Kosovar i Motorizimit kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi. Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme, Bejtush Gashi, ka thënë se kjo marrëveshje konfirmon angazhimin e tyre për ta përmirësuar sigurinë rru-

gore në vend si dhe të bashkëpunojnë në çështjet e lidhura me sigurinë e lëvizjes në rrugë. "Përkrahja e nismave për sigurinë në rrugë përmes programeve të propozuara për kampanja, fushata vetëdijësuese, hulumtime, konferenca, mundëson pjesëmarrjen e përbashkët në rastet kur temat që do të trajtohen dhe kanë një interes të përbashkët", ka thënë ministri Gashi.

Qëllimi i kësaj marrëveshje të bashkëpunimit është të sigurojë një bashkëpunim të vazhdueshëm midis MPB dhe AMRKS nëpërmjet koordinimit institucional të aktiviteteve për sigurinë në rrugë, rrjedhimisht me qëllim të rritjes së sigurisë për të gjithë pjesëmarrësit në trafik. Gjithashtu, MPB dhe AMRKS u pajtuan që të ketë bashkëpunim edhe me institucionet e tjera për siguri në rrugë,

Ministri Gashi kërkon zero tolerancë ndaj shkelësve të rregullave në trafik

"Ministria e Punëve të Brendshme, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, do të jenë të pakompromis ndaj shkelësve në trafik. Me qëllim të ngritjes së sigurisë në trafikun rrugor, do të ndërmarrin veprime policore shtesë. Do të ketë zero tolerancë ndaj shkelësve të rregullave në trafik", ka thënë ministri i Punëve të Brendshme, Bejtush Gashi

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 25 KORRIK - Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme, Bejtush Gashi, ka mbajtur të mërkurën një takim me ushtruesin e detyrës së drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Kosovës, Naim Rexha, me të cilin kanë diskutuar rreth planit veprues dhe parandalues të task forcës e cila parasheh përfshirjen, koordinimin dhe bashkërendimin e njësive të ndryshme në terren, në pika kontrolli, akse rrugore, si dhe aplikimin e metodave të ndryshme të avancuara nga njësitet policore.

Ministri Gashi në këtë takim ka thënë se Policia e Kosovës duhet ta shtojë shqiptimin e gjobave kundrejt shkelësve të rregullave të trafikut deri në vetëdijesimin dhe ndërgjegjësimin e pjesëmarrësve në komunikacion,

duke kërkuar nga qytetarët e Republikës së Kosovës të jenë më bashkëpunues me Policinë e Kosovës në këtë aspekt. "Ministria e Punëve të Brendshme, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, do të jenë të pakompromis ndaj shkelësve në trafik. Do të ndërmarrin veprime policore shtesë me qëllim të ngritjes së nivelit të sigurisë në trafik. Do të ketë zero tolerancë ndaj shkelësve të rregullave në trafik", ka thënë Gashi. Gjithashtu, në këtë takim u diskutua rreth zbatimit të pakompromis të rregullave të reja të trafikut rrugor, ku do të ndikojnë në rritjen e sigurisë në trafik dhe uljen e numrit të aksidenteve të cilat në vitin e fundit kanë qenë tejet alarmante.

Në këtë takim me theks të veçantë u diskutua se aksidentet në përgjithësi, e sidomos humbja e jetëve njerëzore në aksidente trafiku, është shqetësuese

jo vetëm për policinë, por edhe për institucionet e tjera dhe qytetarët në përgjithësi, prandaj kërkohet një mobilizim dhe qasje më gjithëpërfshirëse proaktive nga të gjithë aktorët që kanë rol dhe ndikim në përmirësimin e gjendjes së përgjithshme në këtë fushë.

Ndërsa ushtruesi i detyrës së drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Kosovës, Naim Rexha, ka theksuar se numri i madh i aksidenteve në trafikun

rrugor është bërë mjaft shqetësues tash e sa kohë. Ai ka thënë se Policia e Kosovës do t'i zbatojë me rigorozitet masat që dalin nga Ligji i ri për Rregullat e Trafikut Rrugor. Ligji i ri i Trafikut Rrugor parasheh gjoba të ashpra, por të domosdoshme për të gjithë ata që shkelin rregullat në komunikacion.

Në fund të takimit u tha se Ministria e Punëve të Brendshme dhe Policia e Kosovës kanë ndërmarrë të

gjitha masat për zvogëlimin e numrit të këtyre rasteve në trafik. Gjithashtu, MPB-ja u bënë apel institucioneve relevante, Ministrisë së Infrastrukturës dhe komunave, të ndërmarrin edhe hapa të tjerë me qëllim të minimizimit të aksidenteve në trafik siç janë: përmirësimi i sinjalistikës rrugore dhe mirëmbajtja e akseve rrugore, aty ku rezikshmëria për aksidente të mundshme është më e madhe.

Gashi thotë se Ministria e Diasporës nuk ka buxhet të pamjaftueshëm

Ministri i Diasporës dhe Investimeve Strategjike, Dardan Gashi, gjatë raportimit në Komisionin për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike, i ka njoftuar anëtarët e këtij komisioni për sfidat e kësaj ministrie, duke vënë në dukje buxhetin e pamjaftueshëm për realizimin e projekteve me interes për diasporën

PRISHTINË, 25 KORRIK (ER) - Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike, nën kryesimin e kryetares Vjosa Osmani, ka mbajtur të mërkurën mbledhjen e radhës, në të cilën ka raportuar ministri i Diasporës dhe Investimeve Strategjike, Dardan Gashi. Me këtë rast,

ministri Gashi ka njoftuar për planet dhe politikat e ministrisë që ai udhëheq, e që kanë të bëjnë me promovimin e diasporës dhe krijimin e mundësive sa më të mëdha për ta. Në këtë kuadër ai ka përmendur organizimin e manifestimeve të ndryshme pothuajse në të gjitha qytetet e Kosovës, përpjekjet që

polisat e sigurimit të automjeteve të sigurohen nëpërmjet internetit, si dhe angazhimin e ministrisë që pjesëmarrja në zgjedhje e diasporës të sigurohet nëpërmjet ligjit.

Gjatë raportimit të tij, ministri Gashi ka njoftuar edhe për sfidat e kësaj ministrie, dhe me këtë rast vuri në dukje buxhetin e pamjaftueshëm për realizimin e projekteve me interes për diasporën. Në vijim të fjalës së tij, ministri Gashi vuri në dukje edhe marrëveshjet e nënshkruara me Republikën e Shqipërisë, të cilat kanë për qëllim një angazhim të përbashkët ndërshtetëror për promovimin dhe avancimin e mundësive zhvillimore të diasporës.

Pas kësaj, ministri vuri në dukje edhe sfidat me të cilat ballafaqohet diaspora për ta zhvilluar aktivitetin e vet në kuadër të shoqërive kulturore, për të cilat njoftoi se aktivitetet e realizuara në kuadër të këtyre shoqatave janë zhvilluar pa bazë ligjore të shteteve përkatëse. Pas kësaj, ministri Gashi u është përgjigjur pyetjeve dhe shqetësimeve të anëtarëve të komisionit.



Ahmeti kërkon bashkëpunim me OEK-un për fushën e ndërtimtarisë dhe gastronomisë

Prishtinë, 25 korrik (ER) - Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka pritur të mërkurën në takim kryetarin e ri të Odës Ekonomike të Kosovës, Berat Rukiqi, bashkë me përfaqësues të disa shoqatave që veprojnë brenda kësaj ode.

Në këtë takim u diskutua për fuqizimin e bashkëpunimit në mes të komunës dhe Odës Ekonomike, me ç'rast do të formohet edhe grupi i përhershëm i komunikimit ku do të adresohen çështjet e përbashkëta. "Dy fushat që kërkojnë komunikim më të shpeshtë mes nesh janë ndërtimtaria dhe gastronomia. Me të parët, që nga procedurat për marrjen e lejeve të ndërtimit e deri tek pranimi teknik dhe certifikata e përdorimit; kurse me të dytët, për çështjet si orari i punës

dhe shfrytëzimi i hapësirave publike për tarraca", ka theksuar Ahmeti, përderisa shpjegonte nevojën e bashkëpunimit të ndërsjellë në mes të komunës dhe kësaj ode.

Ndërkaq kryetari i Odës Ekonomike, Berat Rukiqi, ka thënë se Prishtina si Komuna me më së shumti kontribut në rritje të GDP-së dhe në rritje të vendeve të punës. "Ne besojmë se në kuadër të legjislacionit të përgjithshëm mund të gjenden mekanizma stimulues për investime në komuna, veçanërisht në Komunën e Prishtinës. Do t'i kushtojmë rëndësi lobimit edhe në institucione të nivelit qendror për ndryshime të nevojshme ligjore ashtu që të lehtësohen investimet e huaja direkte", ka deklaruar Rukiqi.



Beqaj: Interesim i jashtëzakonshëm i rinisë për ekonominë digjitale

PRISHTINË, 25 KORRIK (ER) - Ministri i Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Besim Beqaj, ka bërë me dije se është i jashtëzakonshëm interesimi i rinisë për ekonominë digjitale. Nëpërmjet një postimi në llogarinë e vet në "Facebook", Beqaj ka theksuar se gjatë këtyre ditëve ka takuar shumë të rinj. "Nga bisedat që kemi si dhe pyetjet që drejtojnë tek ne për programin për mbështetje financiare përmes

granteve të Ministrisë, kuptoj se rinia jonë ka bërë hapa para në idetë e të bërit biznes. Jam i befasuar me idetë brilante, me potencial të madh për qasje në tregjet ndërkombëtare, si konkurrent serioz i ekonomive të zhvilluara evropiane", ka thënë ministri Beqaj. Ai i ka bërë thirrje rinisë që mos të humbë kohë dhe t'i zhvillojë idetë e reja dhe të aplikojë për grante dhe të marrë mbështetje financiare.

MPMS-ja lanson nëngrantet për 27 organizata joqeveritare lokale

PRISHTINË, 25 KORRIK (ER) - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) ka lansuar nëngrantet për 27 organizata joqeveritare lokale të cilat do të ofrojnë shërbime cilësore për fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët dhe të rriturit në nevojë, si dhe për viktimat e dhunës dhe trafikimit. "Angazhimi me përkushtim për rritjen e mirëqenies sociale në mënyrë gjithëpërfshirëse për të gjithë qytetarët, sidomos ndaj grupeve të cenuara, është privilegj, njëherësh përgjegjësi në kuadër të besimit që më është dhënë për ta udhëhequr Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Në kuadër të projektit, 'Mbështetje më të

mira sociale për grupet më të cenueshme në Kosovë', mbështetur nga fondet e IPA-s, sot bashkë me Zyrën e BE-së, organizatën suedeze (SIDA) dhe organizatën 'Save the Children' lansuam nëngrantet për 27 OJQ lokale të cilat do të ofrojnë shërbime cilësore për fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët dhe të rriturit në nevojë, si dhe për viktimat e dhunës dhe trafikimit", ka thënë ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica. Ai ka shtuar se MPMS-ja në bashkëpunim edhe me donatorët dhe partnerët e tjerë do ta fuqizojë edhe më shumë ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare, sidomos për grupet e cenueshme.



Mehmeti: BQK-ja ka ruajtur objektivin e stabilitetit financiar në vend

Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Fehmi Mehmeti, ka raportuar të mërkurën në Komisionin për Buxhet dhe Financa. Ai gjatë raportimit ka theksuar se BQK-ja ka ruajtur objektivitetin e vet, që është stabiliteti financiar. Sipas Mehmetit, gjatë vitit 2017 kishte rritje të investimeve të huaja dhe të remitancave, ndërkaq ka thënë se gjatë këtij viti pritet të ketë ritëm të rritjes ekonomike

EPOKA ERE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 26 KORRIK - Komisioni për Buxhet dhe Financa ka mbajtur të mërkurën mbledhjen e rregullt në të cilën ka shqyrtuar raportin me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare. Nënkryetarja e këtij komisioni nga radhët e PDK-së, Safete Hadergjona, ka paraqitur raportin me të gjeturat nga grupi punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare. "Ne kemi vizituar disa institucione dhe kemi pasur takim me Bankën

Qendrore, Shoqatën e Bankave, Asociacionin e Institucioneve Mikrofinanciare, Njësitin e Inteligjencës Financiare dhe ministrin Jagxhillar. Ky ligj është i zbatueshëm dhe të gjitha rregulloret janë të nxjerra. Gjatë monitorimit kemi vërejtur se për shkak të ndryshimeve që janë bërë në rregulloren e Bashkimit Evropian duhet të bëhen edhe disa ndryshime te ne. Janë 11 rekomandime, por nga ajo që kemi parë në këto institucione, kemi rekomanduar për plotësim-ndryshimin e Ligjit për Banka. Në takimin që kemi pasur me zyrarët e MAPL-së na është paraqitur një rast rreth një institucioni që i është revokuar licenca për ushtrimin e detyrave. Pra, kemi rekomanduar që të gjitha institu-

cionet që nuk i përmbahen rregullores t'u merret licenca", ka deklaruar deputetja Hadergjona. Kurse kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa që vjen nga radhët e LDK-së, Lumir Abdixhiku, ka thënë se janë afër hartimit të Ligjit për institucionet mikrofinanciare. Ai ka thënë se është shqetësuese se si institucionet mikrofinanciare operojnë në Kosovë me aktivitete të larta të kreditimit dhe norma të interesit dukshëm më të larta se në sektorin bankar. Në këtë komision ka raportuar guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Fehmi Mehmeti, i cili ka paraqitur pasqyrën financiare për vitin 2017. Ai ka thënë se ekonomia e Kosovës po vazhdon të rritet dhe se BQK-ja ka arritur ta ruajë objektivitetin e vet, ruajtjen e stabilitetit financiar. "Gjatë vitit 2017 BQK-ja ka arritur t'i realizojë dispozitat e veta. Një vëmendje e veçantë i është kushtuar shërbimit të mirë të ofruar nga BQK-ja. Ekonomia e Eurozonës kishte ndikim në ekonominë e Ballkanit Perëndimor duke dhënë kontribut të rëndësishëm në ngritjen e ekonomisë. Ekonomia e Kosovës po vazhdon të rritet.

Gjatë vitit 2017 janë rritur investimet e huaja direkte. Po ashtu, kishte dhe rritje të remitancave. 759.2 milionë euro ishte rritja e remitancave gjatë vitit 2017. Kjo paraqet një rritje prej 9.9 përqindësh. Bartës kryesor i rritjes së ekonomisë për vitin 2018 priten të jenë investimet publike dhe private", ka thënë Mehmeti. I pyetur për normat e larta të

interesit që praktikojnë institucionet mikrofinanciare, që në mesatare janë 22.4 për qind, Mehmeti ka thënë se BQK-ja nuk mund të ndikojë në zvogëlimin e normave të interesit të institucioneve mikrofinanciare. "Ne si bankë e kemi për detyrë ta rrisim konkurrencën dhe në këtë mënyrë mund të ulet norma", ka thënë Mehmeti.

Zgjedhjet në Kosovë kushtuan mbi 16 milionë euro

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar edhe raportin vjetor financiar të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për vitin 2017. Kryetarja e KQZ-së, Valdete Daka, ka bërë me dije para anëtarëve të Komisionit për Buxhet dhe Financa, se zgjedhjet e vitit të kaluar kanë pasur një kosto mbi 16 milionë euro. Ajo ka thënë se për vitin 2017 KQZ-së i janë ndarë 11 milionë e 613 mijë euro. "KQZ-ja ka organizuar zgjedhjet e parakohshme dhe

ne kemi kërkuar nga Qeveria që të na ndajë buxhet shtesë dhe na është ndarë buxhet në shumën tre milionë euro. Pra, buxheti përfundimtar ka qenë mbi 16 milionë euro apo 2.2 euro për një votues. Për rivotim në Istog kostoja ishte 7 milionë e 824 mijë euro, kurse për votues 3.71 euro", ka thënë Daka. Në këtë kontekst, Daka ka thënë se zgjedhjet lokale ishin më të shtrenjta se ato qendrore për shkak të raundit të dytë dhe Istogut.



Haradinaj përkrah kulturat e bujqve që janë dëmtuar nga breshëri

PRISHTINË, 25 KORRIK (ER) - Kryeministri Ramush Haradinaj ka bërë me dije se vendimi për kompensimin e menjëhershëm të dëmeve të shkaktuara nga breshëri në

komunat e Kosovës është lajm i mirë për të gjithë bujqit tanë. Haradinaj ka bërë me dije se krahas kësaj ka autorizuar Ministrinë e Financave për krijimin e një fondi të veçantë për

vitin 2019 dhe themelimin e komisionit që do të krijojë sistemin e sigurimeve të prodhimtarisë bujqësore në Kosovë. "Si Qeveri e vendit, zotohemi se do t'i qëndrojmë prapa këtij vendi-

mi dhe do t'i ndërmarrim të gjitha masat e nevojshme që t'i përkrahim bujqit tanë dhe ekonominë e vendit", ka shkruar kryeministri Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook".



Latifi kërkon që policia ta shtojë patrullimin në Rahovec

RAHOVEC, 25 KORRIK (ER) - Kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka pritur të mërkurën në takim komandantin e Stacionit të Policisë në këtë komunë, Osman Ismajli, me të cilin ka diskutuar rreth sigurisë në komunikacion dhe liritimit të trotuareve nga shitësit në rrugë dhe bizneset e tjera të cilët ekspozojnë mallin e tyre. Kryetari Latifi ka kërkuar rritje të patrullimit nga policia në mënyrë që siguria në komunikacion të jetë më e lartë. Ai ka thënë se trotualet janë të uzurpuar nga shitësit në rrugë dhe ka kërkuar nga Drejtoria e Inspeksionit që të asistohet edhe nga policia në mënyrë që të lirohen trotualet dhe qytetarët të ecin lirshëm nëpër trotualet. Latifi ka thënë se nuk është për të dënuar askënd, por

nëse ata e kanë shkelur ligjin, sigurisht se do të dënohen bazuar në ligjet relevante që janë në fuqi. Ndërsa komandanti i Stacionit të Policisë në Rahovec, Osman Ismajli, ka thënë se situata e sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit është e qetë dhe kriminaliteti është në rënie. Ai ka bërë me dije se në gjashtëmujorin e parë të këtij viti në Rahovec nuk kanë asnjë rast me vdekje në komunikacion. Kurse sa i përket liritimit të trotuareve, ai ka theksuar se u janë përgjigjur pozitivisht kërkesave të inspektorëve të drejtorisë së Inspeksionit për t'i asistuar në aksionet e tyre për largimin e shitëseve ambulantë të cilët e ekspozojnë mallin e tyre në trotuar dhe që pengojnë lëvizjen e qytetarëve.



Ngordhin peshqit në lumin Mirusha, shkaqet nuk dihen

MALISHEVË, 25 KORRIK (ER) - Në mëngjesin e së mërkurës është vërejtur një dukuri e pazakontë në një pjesë të lumit Mirusha, pasi një pjesë e madhe e fondit të peshkut ka ngordhur. Shkaqet e kësaj dukurie ende nuk dihen, ndërsa inspektorët komunalë të Malishevës janë në terren duke u marrë me rastin. Me të marrë informacionin nga Shoqata e Peshkatarëve Sportivë "Sykuqi", inspektorët komunalë kanë dalë në vendngjarje dhe janë duke u marrë me rastin, të cilët i kanë njoftuar edhe organet qendrore, ndërsa në vendngjarje, së bashku me Shoqatën e Peshkatarëve, është edhe policia. Lidhur me ngjarjen ka reaguar edhe kryetari i



Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, i cili ka kërkuar ndriçimin e rastit dhe gjetjen e shkaktarit të kësaj ngjarje të rëndë, të cilën e ka vlerësuar si katastrofë ekologjike dhe ka kërkuar ndihmën e organeve qendrore, përkatësisht të ekspertëve të kësaj fushe. Edhe Shoqata e Peshkatarëve Sportivë ka kërkuar ndriçimin e rastit dhe gjetjen e shkaktarit të kësaj ngjarje me dëme të pazëvendësueshme.

Kryetari Gashi inspekton punimet infrastrukturore në Obiliq



OBILIQ, 25 KORRIK (ER) - Kryetari i Komunës së Obiliqit, Xhafer Gashi, i shoqëruar edhe nga bashkëpunëtorët, ka përcjellë nga afër punimet e rrugëve që janë duke u zhvilluar në territorin e Obiliqit. Po ashtu, ai ka përcjellë nga afër edhe rrugët që parashihen të punohen në ditët e ardhshme.



Në Marinë u bë rivarrimi dëshmorëve Nebih e Lavdim Vojvoda

SKENDERAJ, 25 KORRIK (ER) - Këshilli Organizativ ka vazhduar aktivitetin për rivarrimin e dëshmorëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës të Zonës Operative të Drenicës në Kompleksin Memorial në fshatin Marinë të Skenderajt. Me nderime të larta ushtarake

dhe shtetërore të mërkurën u bë rivarrimi dëshmorëve të kombit Nebih Vojvoda, Lavdim Vojvoda, dhe pesë dëshmorëve të tjerë. Më vendim të kryeministrit të Qeverisë së Kosovës, Ramush Haradinaj, të datës 08.05.2018, është themeluar

Këshillit Organizativ për rivarrimin e dëshmorëve të UÇK-së të Zonës Operative të Drenicës në varrezat e dëshmorëve në Kompleksin Memorial në Marinë, i cili kryesohet nga ministri për Forcën e Sigurisë së Kosovës, Rustem Berisha.



Mbahen dëgjimet buxhetore në Bashkësinë Lokale Prekaz i Epërm dhe Klinë e Epërme

Skenderaj, 25 korrik (ER) - Në kuadër të ciklit të dëgjimeve buxhetore, kanë vazhduar dëgjimet buxhetore me publikun në Skenderaj, në dy bashkësitë lokale, Prekaz i Epërm dhe Klinë e Epërme. Fillimisht është mbajtur dëgjimi buxhetor në fshatin Prekaz i Epërm, ku para qytetarëve të fshatrave që bëjnë pjesë në këtë bashkësi lokale (Mikushnicë, Lubovec, Prekaz i Epërm, Prekaz i Poshtëm)

nënkryetari i Komunës së Skenderajt, Nuredin Lushtaku, ka folur për rëndësinë e këtyre dëgjimeve, në të cilat qytetarët kanë mundësi t'i adresojnë kërkesat, shqetësimet dhe nevojat e tyre, në mënyrë që ato pastaj të futën në listën e investimeve gjatë viteve në vazhdim. Nënkyetari Lushtaku ka qenë i shoqëruar edhe në kryesuesja e Kuvendit Komunal, Fatbardha Haliti, deputeti në Kuvendin e

Kosovës, Bekim Haxhiu, si dhe drejtorët e drejtorive komunale të Skenderajt. Ndërkaq qytetarët kanë paraqitur kërkesat e tyre, që kishin të bënin kryesisht me investimet në projektet rrugore brenda fshatrave, kanalizimeve, si dhe ujësjellës. Dëgjimi tjetër buxhetor është mbajtur në Klinë të Epërme, në fshatrat që gravitojnë në bashkësinë lokale të Klinës së Epërme (Klinë e Epërme, Klinë e Mesme, Kotorrë, Kuqicë Tërrnac). Atyre është drejtuar kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, i cili ka folur për rëndësinë e pjesëmarrjes së qytetarëve në këto dëgjime, si dhe ka prezantuar punën e përgjithshme që aktualisht është duke u bërë në Komunën e Skenderajt. Ndërkaq qytetarët e fshatrave përreth Klinës së Epërme kanë parashtruar kërkesa për investime në zonat ku ata banojnë, siç janë projektet e infrastrukturës rrugore, kanalizime, ujësjellës si dhe rrethojë për Qendrën e Mjekësisë Familjare në Klinë të Epërme.



Një ‘etimologji’ për vetveten

Prof. dr. Hysen MATOSHI

Mbi disa teza të Jela (Nilović) Mitrović-it, autore e librit “Tajna srpskog jezika kod Hiperborejaca - etimološke beleške srpskog jezika i vranjskog govora rađene pomoću ‘Švedskog jezičkog ključa’” (“Misteri i gjuhës serbe te hiperboreasit -shënime etimologjike të gjuhës serbe dhe të të folmes së Vranjës, të bëra me ndihmën e ‘çelësit gjuhësor suedez’”), botoi Aurora o. d., Vranjë, 2009, 396 f. Asnjëherë nuk është vonë të mësosh. Autorja e librit “Tajna srpskog jezika kod Hiperborejaca - etimološke beleške srpskog jezika i vranjskog govora rađene pomoću ‘Švedskog jezičkog ključa’” (botuar në Vranjë, më 2009), Jela (Nilović) Mitrović, kishte filluar të mësonte suedishten rreth moshës 60-vjeçare. Mjaft inkurajuese për këdo që dëshiron të mësojë qoftë edhe aq sa të mund të komunikojë në gjuhën e një kombi dhe të një vendi ku është ndodhur për një kohë ose ka vendosur të jetojë atje. Mirëpo, të mësuarit e suedishtes i kishte hapur rrugë autores që “të thellohet” në aspekte etimologjike, përkatësisht që fillimisht të vërtonte tezën biblike mbi një gjuhë të përbashkët të botës, e cila, sipas saj, del të jetë pikërisht suedishtja. I gjithë teksti prej qindra faqesh përshkohet nga një përbashkësi e njohurive të fituara në kontekstin e shkollimit (bazuar në të dhënat e prezantuara autorja kishte mbaruar shkollën e lartë pedagogjike për gjuhë dhe letërsi serbe dhe një kohë të gjatë kishte punuar mësimdhënëse e kësaj lënde) me mësimet e reja të suedishtes, duke ndërlidhur aspekte shkencore të materies me ato politike, mitologjike, biblike etj.


Natyrisht objekt i këtij shqyrtimi nuk janë të gjitha pikëpamjet e autores (të cilat, për hir të së vërtetës, duhet thënë se nuk vijnë të sistemuara dhe as të ngritura mbi një parimësi shkencore e metodologjike), sepse kjo do të përbënte një punë shumë të mundimshme dhe jo aq të dobishme për mendimin shkencor përgjithësisht. Libri në fjalë karakterizohet për konstatime që bazohen në analogji tingullore ndërmjet fjalëve në suedisht dhe atyre në sllavisht, madje-madje, në disa raste, edhe në shqip. Natyrisht nuk kemi të bëjmë me kurrfarë afrie të këtyre fjalëve në aspektin semantik. Gjetjet e autores janë tipike për nivelin e parashkencës, të pabazuara në teori të njohura shkencore dhe të pamundshme në aspektin e testimit të vërtetësisë së tyre nëpërmjet metodave të njohura dhe të dijeve të pranura shkencore. Specialistët e këtyre fushave është mirë ta dinë se libri në fjalë është recensuar nga Prof. dr. Javorka Marinković, megjithatë emër i njohur dhe me kontribute në filologjinë serbe, autore e disa teksteve dhe punimeve studimore, e

cila edhe ka botuar në kuadër të librit një vlerësim mbështetës për autoren Jela (Nilović) Mitrović. Teksti prej një faqeje i recensentes përmban, veç tjerash, edhe këtë vlerësim për librin: “Unë qëndroj e mahnitur para kësaj vepre, e cila me aq guxim konteston teoritë kryesore linguistike, ndaj me kënaqësi ia propozoj publikut të gjerë, atyre që kanë dëshirën dhe guximin të vëzhgojnë jashtë kufijve të shkencës, të dëgjojnë diçka të re dhe të mendojnë për të”.

Fjala është për një përpjekje autoriale që mëton të jetë kontribut në fushën e etimologjisë, pa dyshim njëra ndër disiplinat më të vështira e më kërkuuese në studimet linguistike, por, e cila, për fat të keq, në këtë rast nis me një mision politik dhe përfundon me një anekdotë! Që në hapje të librit autorja shpreh: “Ky libër nuk është produkt i ndonjë projekti tim shkencor. Ka lindur me vullnetin e Zotit dhe nën ndikimin e shumë faktorëve të tjerë, të cilët u ndërlidhën rreth meje, kur, në moshë të pjekur, u gjenda në Suedi dhe nisa ta mësoja gjuhën e tyre. Gjyshja e një familjeje serbe qëndronte e ulur në vendin më të sigurt në botë, mësonte suedishten dhe në një kishë suedeze, derisa mbi Serbinë binin bombat e NATO-s, i lutej Zotit: ‘O Zot, ma ruaj familjen, m’i ruaj serbët dhe Serbinë dhe më ndihmo o Zot që ta kuptoj gjithë këtë’”.

Është shumë e kuptueshme se autorja kishte një motiv që ta shkruante këtë libër dhe ai ishte përgjigjja ndaj bombardimeve të NATO-s mbi Serbinë (Jugosllavinë e cinguar, vër. H. M.) dhe jo si ndonjë nevojë për të qartësuar materien studimore dhe për ta argumentuar shkencërisht të vërtetën, të bazuar në referenca të qëndrueshme, në përbashkësi të argumenteve ndërmjet teorive, metodave, shkollave të ndryshme të dijes, pikëpamjeve të autorëve referentë etj.

Uvertura e këtij libri është plotësisht e kompatibël me përfundimin e tij, përkatësisht atipike për një tekst me çfarëdo pretendimesh shkencore nga fusha e studimeve etimologjike. Sikurse u tha, ai përmbillet me këtë “anekdotë serbe”, të cilën autorja e rrëfen kështu, gjithsesi duke e vënë theksin te “karakterit hyjnor” i kombit të saj: “Dhe në fund po e paraqesim edhe një anekdotë, e cila flet për atë se si serbët e kanë fituar territorin e sotëm. Në kohën kur Zoti ua kishte ndarë të gjithë popujve vendet në të cilat do të jetonin, nga diku ia behën serbët, të cilët dolën para Zotit dhe i kërkuan që t’i vendoste diku. Zoti u befasua kur e pa se kishte ende popuj të pasistemuar dhe i pyeti se ku ishin deri tani. “Kemi bredhur, o Zot”, i thanë serbët. Zoti, duke mos ditur se çfarë të bënte me ta, heshti një kohë të gjatë, pastaj u tha: “Nuk di çfarë të bëj. Mund vetëm t’ju jap këtë pjesë toke të cilën e kam pas ndarë për vete! Unë edhe ashtu



për pak kohë do të udhëtoj”. Dhe kështu serbët e fituan territorin të cilin Zoti e kishte ndarë për vete dhe për shpirtin e vet! Se çfarë vendi është ky flet fakti se serbët nuk kanë mundur që ta shmangin as edhe një luftë të vetme. Të gjithë të fortit janë përpjekur që t’ua rrëmbejnë atë copë toke, por Zoti gjithnjë ua ka kthyer serbëve këtë territor, pasi që janë qetësuar ndjenjat. Serbët e dinë këtë dhe ndaj po heshtin e po presin.”

Nëse lexuesi do ta kishte të qartë këtë ndërlidhje ndërmjet hyrjes dhe përfundimit, me të drejtë, do të mund ta shtronte pyetjen pse duhet të lexohet ky libër dhe pse duhet të flitet fare rreth tij. Madje, edhe e gjithë përpjekja e autores për të argumentuar del krejt e panevojshme, meqë ajo e ka të qartë caktimin e Zotit. Mjafton që t’i lutet Atij! Megjithatë, intenca e saj, jashtëzakonisht e qartë, është që për këtë “fakt” të binden edhe njerëzit.

Nëse do të përmbledhim qëllimin themelor të këtij libri pa dyshim se do të mund ta formulonim si një përpjekje për të dëshmuar se serbët janë autoktonë në Ballkan që nga koha kur “Zoti ua dha pjesën e tokës që kishte ndarë për vete” dhe se popujt e tjerë, në rend të parë shqiptarët, nuk janë popull autokton në Ballkan, nuk janë pasardhës të ilirëve, por të ardhur, sipas supozimeve të saj, nga viset nordike e të fuqizuar në hapësirën e sotme vetëm në kohën e Perandorisë Osmane, e cila i kishte mbledhur “parashqiptarët” nëpër Evropë me qëllim që si luftëtarë t’i kishte në krahun e saj! Çelësi gjuhësor i suedishtes është argu-

menti më i madh i autores dhe ky fakt është vënë edhe në përfundimet e librit: “Nëpërmjet çelësit gjuhësor të suedishtes bëhet e qartë se kush janë shqiptarët dhe nga kanë ardhur në Ballkan, qartësohet se sllavët e jugut nuk janë vendës por ilirë, ndërsa shqiptarët dhe “albancët” (“Šiptari i Albanci”, sipas saj ka dallim ndërmjet tyre, vër. H. M.) janë popull i cili fillimisht në të kaluarën e largët ka bërë një rrugë të gjatë nga jugu i Evropës deri në veri ku kanë qëndruar gjatë, por përsëri janë shpërndarë nëpër territorin evropian. Falë turqve, ‘albancët’ dhe shqiptarët (“Albanci i Šiptari”), ndodhen këtu ku janë sot.”

Pra, Jela Nilović - Mitrović, në këtë libër merret edhe me shqiptarët, gjenezën e tyre, historinë, gjuhën shqipe etj., në përpjekje për të dëshmuar se shqiptarët si popull na qenkan vendosur në tokën serbe dhe se si edhe deri në ditët e sotme ata po luftuan për t’i dëbuar serbët dhe për t’i zënë hapësirat e tyre! Teza për shqiptarët si ardhacakë në Ballkan nuk është e re, por e re është “zgjidhja” që kjo autore e ofron për gjenezën e shqiptarëve. Pikëpamja e saj për gjuhën shqipe si gjuhë e veçantë e shpie në konstatimin se parashqiptarët do të kenë jetuar në ndonjë hapësirë tejet të izoluar: “Karakteristika themelore e gjuhës shqipe është se kjo gjuhë i ka ruajtur veçantitë e saj nga që ka qenë e izoluar në pjesën më veriore të Evropës dhe jo në Ballkan, sepse Ballkani është shumë i frekuentueshëm. Populli parashqiptar nga ato territore ka ardhur me fondin e vet të fjalëve, por edhe me veçantitë e organit të

tyre të të folurit, që na e ka dhënë Zoti, të cilat veçanti të parët i përcjellin te pasardhësit e tyre. Njëra nga karakteristikat e kësaj gjuhe është se shpesh gjejmë mosthek-simin e zanoreve dhe grumbullimin e bashkëtingëlloreve, si në gjuhët arabe...” , duke vijuar në këtë kontekst “argumentues” me vënien në pah të pranisë në gjuhën shqipe të bashkëtingëllores “h”, por dhe zanores “ë”, e cila, sipas saj, i përgjigjet tingullit “ö” ose “ä” të suedishtes.

Ferizaj dhe Tasjani - “emërvende në suedisht”!?

Duke qenë se për një vit kishte punuar në Ferizaj (në kuadër të Yu-progamit të Lidhjes Komuniste të Jugosllavisë dhe të strukturave shtetërore institucionale jugosllave si zbatuese të këtij programi) si mësuese e gjuhës serbe edhe në paralelet shqiptare, (mbase) autorja do të ketë përsiatur që atëherë për toponimin Ferizaj (Tasjan, Uroševac), por gjithsesi vajtja në Suedi e kishte bindur se toponimet që përdorëshin para “pagëzimit” të këtij vendi me emrin e mbretit Uroš (1914, vër. H. M.) ishin hiq më pak se suedeze, përkatësisht nordike!? Duke mësuar suedishten, ajo e kishte “mësuar” edhe të vërtetën për këto toponime, të cilat i shpjegon në këtë mënyrë: “Emërtimin Uroševac serbët e kanë formuar sipas mbretit Uroš, ndërsa dy emërtimet paraprake kanë dalë nga penat e hartografëve nordikë. Ferizaj = suedisht: för is aj!; Tasjan = suedisht: tass i jan.

För (parafjalë) - për isen (em.) - akull aj! (pasthirmë) - aj, jaoj! Për akull, aj!

Këto fjalë na e qartësojnë situatën sipas së cilës është fjala për dimrin dhe se hartografët në punën e tyre kishin probleme me akullin, i cili ua vështirësonte lëvizjen. Ndoshta në vetë hartën ishte e shkruar vërejtja: Tasjan: tass, tassen; tassar (em.) - shputë, këmbë, Jan (emër mashkulli).

Suedezyt e kanë traditë që t’i shkruajnë të bashkëngjitura si një tërësi disa fjalë. Sigurisht që kështu bëjnë edhe hartografët. Autoritetet e një popullit të një treve të porsaevidentuar, që në kohën e përfshirjes në hartë ka qenë e vështirë të pranojnë “ta blujnë” apo “ta hekurosin” atë emërtim. Sigurisht që ai emërtim do t’i përjetojë disa përshtatje në përputhje me ndjeshmërinë gjuhësore të atij populli, përkatësisht disa përshtatje aparatit të tyre të të folurit. Tasjan: shputa te Jani. Është më se e sigurt se Jani ka ndërtuar diçka që ka ngjarë në kthetrat e kafshëve që e ka ndihmuar të ecte mbi akull. Në kohën e çlirimit nga turqit shfaqej si pengesë gjithçka që i kujtonte turqit, madje edhe emërtimi i qytetit që asocionte në Feriz Pashën, turkun famëkeq”.

(Vijon / Fusnotat i ka hequr redaksia)

EKREM BARDHA, SHQIPTARO-AMERIKANI QË LOBOI AQ SHUMË PËR LIRINË DHE PAVARËSINË E KOSOVËS (4)

Presidentët Clinton dhe Bush ia mbajtën fjalën Ekrem Bardhës për Kosovën

- Shqiptari që takoi gjashtë presidentë amerikanë, sekretarë shteti, senatorë, kongresmenë, ambasadorë... U arratis nga Shqipëria, por kurrë dheun, vendin e vet, nuk e tradhtoi. Kosova ishte zemra e tij.



Shkruan: Ferdinand SAMARXHI,
Fitues i Antenës së Artë Mjeshtër i Madh

Presidenti Clinton erdhi në Miçigan dhe kërkoi takim me familjen Bardha, me Ilirin, zonjën Lumturi dhe me ju, z. Bardha. Kishte marrë vesh për një e-mail që vajza juaj kishte shkruar nga Tirana, kur strehonte vëllezërit kosovarë me stafin e "Piazzës". Përse presidenti Clinton e kërkoi takimin me ju?

Ekrem Bardha: Lufta për çlirimin e Kosovës pati edhe dramën e saj njerëzore. Të detyruar nga gjenocidi dhe vrasjet masive të popullsisë shqiptare në Kosovë nga ushtria dhe policia serbe, qindra e mijëra kosovarë u shpërngulën nga shtëpitë e tyre duke shkuar në Shqipëri dhe Maqedoni. Televizioni "CNN" transmetonte nga Tirana, raste barbare të kryera

nga ushtria e Millosheviqit ndaj popullsisë shqiptare, kryesisht grave dhe vajzave të mitura. Iliri i shkroi Donikës, motrës së tij, që në atë kohë jetonte në Shqipëri, dhe e pyet se çfarë po ndodh. Donika, e cila në atë kohë jetonte në Tiranë dhe administronte restorantin tonë "Piazza", i shkruan një e-mail të gjatë Ilirit. Atë ditë, Donika shkoi ta vizitojë kampin e refugjatëve dhe mësoi për një çadër ku rrinin katër vajza të mitura, që nuk dilnin nga çadra për shumë ditë, dhe të gjithë u bënë merak. I thanë Donikës që ato ishin shumë të tronditura dhe të turpëruara nga abuzimi, nga përdhunimi nga paramilitarët serbë në një kazermë, dhe shkullnin flokët dhe qanin. Donika dërgoi një vajzë për të pyetur nëse kishte mundësi për t'i takuar dhe biseduar me ato vajza. Përgjigja ishte negative, mbasi vajzat nuk pranonin të takonin asnjëri. Atëherë Donika u kthye në shtëpi e tronditur vetë nga situata, dhe i shkruan Ilirit ngjarjen me shumë detaje për historinë e vajzave në çadër, si dhe për situatën e përgjithshme të refugjatëve që po hynin në Shqipëri. Dua të bëj një parantezë këtu për të thënë dy fjalë për Donikën, e cila ka qenë pranë meje në të gjitha

betejat e rëndësishme që ne kemi bërë për çështjen kosovare. Donikën e kam pasur në krah, si një këshilltare shumë të mirë që me çështjen Ivezaj, gjatë dëshmisë sime në nënkomisionin e të Drejtave të Njeriut në Kongresin Amerikan, por dhe në takimet e shumta me kongresistë, senatorë dhe zyrtarë të lartë të Departamentit të Shtetit. Gjatë kohës së fluksit të madh të refugjatëve kosovarë në Shqipëri, në

im, nga Donika. Ai u emocionua dhe u prek shumë nga kjo letër dhe më tha që nesër, d.m.th të hënën ai do të shkonte në Uashington në Shtëpinë e Bardhë dhe do ia jepte personalisht këtë letër president Clinton. Kështu ndodhi. Kongresisti David Bonior më lajmëroi që ishte takuar me presidentin Clinton dhe kur ia kishte lexuar e-mailin, ai ishte prekur shumë nga kjo ngjarje, kishte lotuar dhe kishte kërkuar më



Fotografi nga takimi i Ekrem dhe Lumturi Bardhës me presidentin George Bush

Kukës, por dhe në qytetet e tjera të vendit, Donika ishte në Tiranë ku merrej me administrimin e restorantit tonë. E përfshirë shpirtërisht me problemin kosovar, ajo u kujdes për strehimin e 220 refugjatëve, ndërsa vendosi personelin e restorantit "Piazza" në dispozicion të përgatitjes dhe dërgimit të ushqimeve në çadrat e refugjatëve për një periudhë të gjatë kohore me shpenzimet e saj. Këto kontakte të përditshme të Donikës me refugjatët e luftës të ardhur nga Kosova, sollën dhe dëshminë e dhimbshme të këtyre vajzave kosovare, të traumatizuara nga tmerrri çnjerëzor që kishin kaluar. Letra e Donikës nuk kishte vend për komente dhe më vinte keq për viktimat e pafajshme, të plagosur, gjymtuar, që kishin nevojë të mjekoheshin sa më parë. Menjëherë shpreha dëshirën të jepja një ndihmë për fëmijët e dëmtuar nga lufta. Ishte ditë e diel kur takova kongresistin David Bonior dhe i fola për masakrat dhe politikën çnjerëzore serbe ndaj shqiptarëve në Kosovë, i foli dhe për refugjatët e Kosovës në Shqipëri si dhe konkretisht u ndala të letra që kishte marrë Iliri, djali

shumë informacion se kush e kishte dërguar atë. Sipas kongresistit Bonior, presidenti ishte shprehur se kjo situatë nuk duhet lejuar më. Nisur nga ngjarje dhe nga e-maili i Donikës, kur presidenti Clinton erdhi në Roseville, në Miçigan, kërkoi të takohet me familjen Bardha, dhe donte të takonte Iliri për ta pyetur për email-in. Në prill të vitit 1999, në mes të




Në konferencën e jashtëzakonshme para ndërhyrjes ushtarake

fushatës më të egër serbe kundër popullsisë shqiptare, vrasjeve barbare, rrëmbimeve, përdhunimeve dhe plaçkitjeve, presidenti Clinton erdhi në shtetin e Miçiganit, ku zhvilloi një takim me zgjedhësit në qytetin Roseville. Aty ishin ftuar edhe shqiptarë. Dëshira e tyre ishte t'i shprehnin mirënjohje Clintonit dhe ta falënderonin për çfarë ai kishte bërë dhe po bënte për Kosovën. Të gjithë e kishin kuptuar se pa vendosmërinë dhe shtytjen e qeverisë amerikane, nuk mund të fillonin veprimet ushtarake të NATO-s kundër Jugosllavisë. Pas takimit elektoral në Roseville, presidenti u takua me mua, Ilirin, dhe bashkëshorten time, Lumturi Bardhën. Takimi u zhvillua privatisht dhe pa media. Gjatë bisedës me presidentin Clinton pashë shqetësimin e tij, të cilën e shprehte hapur, ndaj masakrave që po ndodhnin në Kosovë dhe u interesua të mësonte nga ana jonë se si po e ndihmonte diaspora popullatën e shpërngulur me dhunë në Shqipëri, Maqedoni dhe në Mal të Zi. E informuam për veprimtarinë që kishte zhvilluar diaspora dhe ndërkohë e falënderova duke i thënë se shqiptarët e Kosovës dhe të Shqipërisë ndienin për të po aq respekt sa kishin për presidentin Woodrow Wilson, i cili



Lumturi Bardha, presidenti Ford, Ekrem Bardha.

Ekrem Bardha dhe bashkëshortja e tij me presidentin e 38 të ShBA-së, Gerald Ford



Letrat falënderuese të presidentëve Ronald Reagan dhe George W. Bush dërguar Ekrem Bardhës



onshme që u mbajt për çështjen e Kosovës,
merikane. Michigan, 16 prill 1999.

Presidenti Bill Clinton në konferencë të jashtëzakonshme për Kosovën. Në fotografi, ulur nga e djathta, Ekrem Bardha

e shpëtoi Shqipërinë nga copëtimi më 1918-n. Gjithashtu i shpreha shqetësimin që kishim të gjithë. I thashë presidentit Clinton që të vinte dorën në zemër dhe ai e Qeveria amerikane të bënin çfarë të ishte e mundur për të shpëtuar këtë popull nga mizoritë e shfarosjes së politikës serbe. Presidenti Clinton theksoi se "Millosheviqi ishte një kasap, por krimet e tij nuk do të vazhdonin gjatë. Një ditë ai do të ndëshkohej si kriminel lufte". Presidenti pyeti lirin për letërën e marrë nga motra e tij Donika, se si kishte ndodhur tragjedia e katër vajzave të mitura kosovare, të cilat nuk dilnin nga çadrat e tyre pas asaj që kishte ndodhur. Unë pashë presidentin Clinton të prekej shumë gjatë shpjegimit që liri i bëri letërës së Donikës. Kisha përballë njeriun më të fuqishëm të botës të prekej aq njerëzishëm dhe të përjetonte po aq fort sa dhe ne, tragjedinë e shqiptarëve të Kosovës të shkakuar nga regjimi serb. Ai premtoi se "Amerika duhet të veprojë që të mos e lejojë këtë gjenocid". Në fund të takimit ne bëmë edhe një foto me presidentin Clinton.

Në tetor të vitit 1999 familja Bardha mori një letër falënderimi nga presidenti Clinton, letër e cila konsiderohet si një dhuratë e çmuar, por dhe si një premtim pozitiv për të ardhmen e Kosovës.

Në vitin 2004 ju keni dhënë përkrahje financiare për dy partitë, atë Republikane dhe Demokratike. Si e shpjegoni këtë? Cili ishte qëllimi?

Ekrem Bardha: Presidenti i sapozgjedhur George Bush më dërgoi një letër me shkrim dore, ku më falënderonte për ndihmën që i kisha dhënë në Michigan gjatë fushatës së vitit 2004, zgjedhje në të cilat ai kishte arritur një fitore të jashtëzakonshme me mbi 61 milionë vota në total. Unë financova 100 mijë dollarë amerikanë në

mbështetje të presidentit republikan, George W. Bush. Gjatë një takimi elektorale në Michigan në vitin 2004, pata rastin të bisedoj me presidentin e Shteteve të Bashkuara, George W. Bush. Ai foli me biznesmenë e personalitete shtetërore, në Dearborn të shtetit të Michiganit. Pasi iu prezantova si shqiptaro-amerikan, i kujtova presidentit që të mos lërë në harresë çështjen e Kosovës dhe Shqipërinë, në të mirë të vetë politikës së jashtme amerikane. "Si e the?" - pyeti i habitur presidenti, - "Kosovo apo Kosova?" "Po ua shqiptoj ashtu siç e quajë unë dhe shqiptarët: "Kosova". Dhe ai e përsëriti, "Kosova". Është ndoshta një detaj i vogël, por me domethënie të madhe. Presidenti Bush u bë kështu i pari udhëheqës i rangut botëror që përmendi Kosovën me emrin me të cilin e thërrasin shqiptarët që përbëjnë shumicën dërrmuese të popullsisë së saj.

Duke përfituar nga situata, i them: "Zoti president, babai juaj kur ishte në krye të Shtëpisë së Bardhë, bëri një deklaratë të madhe duke i dalë në mbrojtje Kosovës". Ai e pohoi deklaratën time dhe tha se do t'i qëndronte besnik asaj politike. Në dhjetor të po atij viti, unë mora një letër falënderimi nga presidenti Bush për mbështetjen që i kisha dhënë gjatë fushatës zgjedhore, përmes së cilës ai u rizgjodh me një fitore historike, rekord, siç e shpreh edhe vetë në letër, me mbi 61 milionë vota. Letër falënderimi nga presidenti George W. Bush mora dhe pas zgjedhjes së tij në krye të Shtëpisë së Bardhë. Më 15 janar 2001, pak ditë para se të bënte betimin në Shtëpinë e Bardhë, presidenti i 43-të i SHBA-së, George W. Bush, më dërgoi një letër përmes së cilës më falënderonte për ndihmën që unë i kisha dhënë fushatës së tij presidenciale dhe zgjedhjes në krye të vendit. Në maj të vitit 2004, gjatë fushatës

presidenciale, shqiptarët e Amerikës mblodhën gjysmë milioni dollarë për kandidatin demokrat për president, John Kerry. Në Nju Jork u zhvillua një fundraiser (fushatë për të mbledhur fonde) ku merrnin pjesë diplomatë dhe personalitete të shquara të politikës amerikane, si Richard Holbrooke, gjenerali Wesley Clark, David Philips, aktori Sam Waterson që drejtonte darkën, ishte dhe vëllai i John Kerry, Cameron Kerry, kongresisti Eliot Engel ... Përveç meje, nga komuniteti ynë kishte shumë pjesëmarrës, si Ilir Zherka, që ishte dhe drejtor i Këshillit Shqiptaro-Amerikan, Jim Xhema, Harry Bajraktari, Richard Lukaj, Agim Rexhaj, Dino Erbeli, Bruno Selimaj, vëllezërit Bytyçi, Skënder Xhilanga, Musli Mulosmani, Donika Bardha, Lekë Gocaj etj. Të pranishmit theksuan se kjo mbrëmje në mbështetje të kandidatit për president John Kerry, përbënte një sukses historik dhe se komuniteti shqiptaro-amerikan kishte lënë gjurmë vendimtare në fushatën e kandidatit John Kerry. Kjo mbrëmje tregoi se në politikën amerikane shqiptarët janë një forcë e madhe dhe se ata kanë miq të vërtetë si Richard Holbrooke, gjeneralin Clark etj. Për të pasur vëmendjen e presidentit amerikan që do të dilte nga zgjedhjet presidenciale të vitit 2004, si pjesë e komunitetit shqiptar në SHBA, unë vendosa të financoj në fushatat e të dy kandidatëve. Përveç financimit të fushatës të presidentit George Bush Junior, me 100 mijë dollarë, unë financova edhe 100 mijë dollarë për kandidatin demokrat John Kerry, nga i cili gjithashtu mora falënderim për mbështetjen që i dhashë. Mora letra falënderimi si nga presidenti Bush në mandatin e dytë, ashtu dhe nga kandidati demokrat Kerry, por dhe personalitete të shquara të politikës së lartë amerikane, si Richard Holbrooke apo Madeleine Albright.

Veprimtaria juaj e madhe e lobimit për çështjen shqiptare tërhoqi vëmendjen e studiuesit amerikan Edwin E. Jacques i cili ka shkruar për ju në librin e tij studimor për historinë e popullit shqiptar të cilit i mori 20 vite kohë studim, dhe i cili është botuar edhe në shqip në vitin 2004 dhe në faqet 624-626 ai i referohet aktivitetit të komunitetit

shqiptar në Amerikë për mbrojtjen e të drejtave të qytetareve shqiptaro-amerikane. Ja çfarë shkruan Edwin Jacques në librin e tij për Ekrem Bardhën: Ja shembulli i mirë i asaj që mund të bënte një njeri për të protestuar kundër shkeljeve të tilla të të drejtave të njeriut, ishte aktivisti i palodhur Ekrem Bardha.

Ekrem Bardha u largua nga Shqipëria vite më parë dhe u vendos në zonën e Detroitit. Ai u tregua veçanërisht i ndjeshëm ndaj dramës së Pjetër Ivezajt, një emigrant shqiptar nga Kosova,

vëmendjen Ambasadës jugosllave dhe shtatë muaj pas burgimit, Ivezaj u lirua menjëherë. Broomfieldi u shpreh: 'Nuk duhet të lejojmë që vendet e tjera të gëzojnë përfitimet e tregtisë me Shtetet e Bashkuara për sa kohë që ato vazhdojnë të shkelin normat themelore të dinjitetit njerëzor, të cilat janë kaq të rëndësishme për ne'.

Z. Bardha, jeni shqiptari që lobuat shumë, bashkë me familjen tuaj, për çështjen e Kosovës që ajo të ishte sot e lirë dhe e pavarur.



Ambasadori William Walker, Ekrem Bardha dhe ish-komandanti suprem i NATO-s në Evropë, Wesley K. Clark

Jugosllavi, i cili u bë qytetar amerikan dhe më vonë u kthye në Jugosllavi që të vizitonte të afërmit. Atje e arrestuan dhe e dënuan me shtatë vjet burgim pasi kishte marrë pjesë në një demonstratë paqësore pesë vjet më parë në Uashington D.C.

Ekrem Bardha vendosi që ta ndihmonte. Ai i bëri apel William Broomfield-it, deputetit të tij nga Michigan në Kongresin e Shteteve të Bashkuara. Broomfieldi e pranoi se, ashtu si të gjithë qytetarët e tjerë perëndimorë që i gëzonin në mënyrë të pakufizuar të drejtat njerëzore, e kishte të vështirë të kuptonte kufizimet që i kishin bërë Ivezajt. Ngaqë ndërhyrja e tij në Departamentin e Shtetit nuk ishte fort premtuese, ai e shtroi çështjen në Kongres, i armatosur me materiale nga "Amnesty International". Brenda dy orësh, tha ai më vonë, siguroam firmat e 150 kongresmenëve për t'i mohuar Jugosllavisë statusin e kombit më të favorizuar'. Ky veprim i tërhoqi menjëherë

Ndiheni krenar që lufta, puna, përkushtimi juaj patriotik, atdhetar, nga një ëndërr që ju e mendonit dhe që të tjerët nuk e besonin, është sot një realitet, Kosova është shteti më i ri në hartën e botës, shteti i dytë shqiptar. Si e shihni ju sot Kosovën, zhvillimet dhe perspektiven e saj?

Ekrem Bardha: Është një fat i madh që sot Kosova është e lirë dhe e pavarur, shteti dytë shqiptar më i ri në hartën e botës. Sot Kosova si një shtet i ri pavarësisht disa problemeve ekonomike të dala nga lufta dhe jetëgjatësisë saj si shtet prej 10-vjetësh po ecën në të gjitha drejtëtimet, po konsolidohet si shtet, jo vetëm brenda vendit, por edhe në arenën ndërkombëtare. Perspektivat e Kosovës janë shumë të mira. E ardhmja e saj do jete gjithnjë e më e mirë. Sot dhe në të ardhmen Kosova do te luajë dhe do të jetë një faktor i rëndësishëm për paqen dhe sigurinë në Ballkan. I nderuar z. Ferdinand, në takimin në Rambuje, zonja Ollbrajt gëzonte dhe shprehu një simpatë të veçantë për z. Hashim Thaçi, dje udhëheqës politik i UÇK-së, sot president i Republikës së Kosovës: "Është një djalë energjik, i zgjuar, por i vështirë në bisedime". Është fjala për vendosmërinë që z. Thaçi tregonte dhe kërkonte me këmbëngulje në takimin e Rambujesë, pavarësinë e Kosovës. Unë dua ta mbyll intervistën time duke shprehur respekt dhe mirënjohje për z. Thaçi që ashtu siç tregoi dje vizion për udhëheqjen e luftës së UÇK-së, sot ai po lufton për konsolidimin, rritjen e rolit dhe prestigjin e shtetit të Kosovës në arenën ndërkombëtare, bashkë me z. Ramush Haradinaj, kryeministër. Faleminderit! **(Fund)**



Fotografi nga takimi i Ekrem Bardhës dhe vajzës së tij, Donikës, me zëvendëspresidentin amerikan Joe Biden

E rrallë

Ndërtesa shembet pas reshjeve të pandërprera të shiut

Një ndërtesë e lartë është shembur në Stamboll të Turqisë pas rrebesheve të pandërprera të shiut që kanë rënë atje. Reshjet kanë bërë që të rrëshqasë dheu në një zonë ndërtimi, më pas edhe të shembet ndërtesa katërkatëshe.



FOTO E DITES




Konkurrentët luftojnë për topin gjatë një ndeshje në lojën me baltë në Brunsbuettel të Gjermanisë. /AFP/

E jashtëzakonshme

Bën selfien vdek-jeprurëse në syrin e gjarprit helmues

Një djalë ka rrezikuar jetën për një selfie nga syri i një gjarpri helmues. Gerhard van de Westhuizen nga Afrika e Jugut kapi refleksimin e tij në syrin e zvarranikut. Këto specie konsiderohen më të rrezikshme se kobrat dhe kanë më shumë helm



se mambat e zeza pasi shkaktojnë gjakderdhje të brendshme tek njerëzit.

BARSOLETA E DITËS



Testamenti i një biznesmeni para se të vdesë:
- Shtëpinë dhe tokën ia lë gruas.
- Veturën, firmën dhe 100 mijë euro ia lë djalit.
- E vëllait, që më thoshte se shëndeti është me rëndësi sesa paraja, ia lë patiket dhe trenerkat, le t'i veshë e le të vrapojë.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjate vikendit
në ora 16:00

“INCREDIBLES 2” 3D

I Animuar/Aksion/Aventure; 1 ore 58 min

Rolet: Holly Hunter, Craig T. Nelson, Sarah Vowell, Huck Milner, Samuel L. Jackson, etj.

Regjia: Brad Bird




Në ora 18:20

“FUTURE WORLD”

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 41 min

Rolet: James Franco, Suki Waterhouse, Milla Jovovich, Lucy Liu, Jeffrey Wahlberg, Snoop Dog, etj.

Regjia: James Franco



Në ora 20:00

“ANT-MAN AND THE WASP” 3D

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 1 orë 58 min

Rolet: Paul Rudd, Evangeline Lilly, Michael Pena, Michael Douglas, Michelle Pfeiffer, Laurence Fishburne, etj.

Regjia: Peyton Reed



Në ora 22:00

“LOVING PABLO” (R)

Biografi/Krim/Drame; 2 ore 03 min

Rolet: Javier Bardem, Penélope Cruz, Peter Sarsgaard, etj.

Regjia: Fernando León de Aranoa



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.



DASHI

Sot me shumë mundësi do të zhgënjeheni nga disa persona dhe shumë ëndrra tuaja nuk do të bëhen realitet. Do të nervozoheni herë pas here.



DEMI

Gjatë kësaj dite do të keni shanse të nisni një histori të këndshme dashurie apo të provoni ndjenja të cilat do t'ju lënë pa frymë. Argëtimet do të jenë të shumta.



BINJAKËT

Do t'ju duhet të zgjidhni mes çështjeve të dashurisë dhe atyre të punës gjatë kësaj dite. Peshojini mirë gjërat dhe vendosni se cilat janë më të rëndësishmet për ju.



GAFORRJA

Do të keni disa takime shumë të këndshme me persona të seksit të kundërt. Do t'ju tërheqin tej mase disa njerëz të rinj, me të cilët do të hyni menjëherë në bisedë. Forconi pozicionin tuaj përpara të tjerëve.



LUANI

Sot mund të keni dështime të njëpasnjëshme në anën financiare apo në atë profesionale. Edhe pse mund të keni bërë plane afatgjata, të cilat mendoni t'i realizoni, një gjë e tillë nuk do të jetë aspak e mundshme.



VIRGJËRRESHA

Duhet të tregoheni të vendosur dhe të merrni disa vendime të rëndësishme në anën profesionale. Bëni atë që ju mendoni se është më e mira për ju, duke bërë kompromis me të tjerët.



PESHORJA

Është një ditë shumë e mirë për t'u argëtuar në ambientet e jashtme të shtëpisë. Nëse doni mund të bëni një udhëtim në një qytet tjetër apo të qetësoheni në një vend larg zhurmave, në ajër të pastër.



AKREPI

Është një ditë shumë e mirë për të pushuar, për të garuar me disa persona dhe për të medituar në lidhje me të shkuarën dhe planet tuaja në të ardhmen. Do të bëni disa biseda të gjata, të cilat do t'ju orientojnë drejt interesave tuaja.



SHIGJETARI

Do të jetë një ditë e mbushur me ulje dhe ngritje. Do të bëni disa udhëtime të shkurtra, do të kujdeseni për familjen, në të njëjtën kohë do ta jepni maksimumin në punë.



BRICJAPI

Takimi i papritur me një person të dashur apo me një mik të largët do t'ju prishë të gjitha planet që keni parashikuar për këtë ditë. Bëni mirë të mos neglizhoni çështjet më të rëndësishme, në veçanti punën.




UJORI

Do të jetë një ditë e mirë për të bërë blerje. Kjo nuk do të thotë se duhet të shpenzoni shuma marramendëse, por diçka që jua lejon xhepi dhe niveli juaj ekonomik.



PESHQIT

Dita do të nisë e qetë. Përdorni të gjithë informacionet që keni në dispozicion dhe do të arrini gjithçka që doni. Mund të keni një rritje serioze në detyrë apo të forcoheni brenda një marrëdhënie në çift apo mes miqsh.



PROGNOZA SPORTIVE

HAJDUK SPLIT - SLAVIA SOFIA

3+

ST GALLEN - SARPSBORG

1-1

CSKA SOFIA - ADMIRA

1

Liria dhe Drenica në aksion

Futbolli i Kosovës do të jetë interesant edhe në edicionin 2018/2019, pasi klubet janë treguar mjaft aktive në këtë afat kalimtar. Madje në ditët e fundit kanë reagu edhe dy klubet që në shumicën e kohës kanë qëndruar në heshtje rreth afrimeve të lojtarëve, Liria dhe Drenica, të cilat kanë realizuar nga dy transferime mjaft të rëndësishme

**EPOKA
ERE****Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 25 KORRIK - Dy skuadrat që janë goditur më së shumti nga largimet në këtë afat kalimtar, Liria nga Prizreni dhe Drenica nga Skenderaj, janë treguar mjaft aktive ditët e fundit në afatin kalimtar. Në skuadrën e Lirisë ka ndodhur rikthimi i madh i Robert Gjerajt, i cili edicionin e kaluar ishte përjashtuar dhe detyruar të largohet nga klubi për shkak të raporteve aspak miqësore me trajnerin nga Shqipëria, Bledi Shkëmbi.

Gjeraj në pjesën e dytë të edicionit të kaluar e kishte djersitur fanellën e Besës së Pejës, skuadër me të cilën nuk arriti të mbijetonte në Vala Superligë. Të mërkurën skuadra prizrenase, përveç

Gjerajt, zyrtarizoi edhe Valon Bytyqin, i cili luan në pozitën e mbrojtësit dhe ishte pjesë e rëndësishme e skuadrës së Ballkanit në garën për t'u rikthyer në elitën e futbollit të Kosovës.

Aktive ishte edhe Drenica, e cila ka pësuar shumë ndryshime në këtë afat kalimtar. Drejtuesit kuqezi, pasi e blinduan mesfushorin me përvojë të madhe, Taulant Dajakun, e kanë transferuar nga Feronikeli, Qemail Elshanin, i cili në të kaluarën me plot sukses ka luajtur për Drenicën, pastaj edhe për Besën dhe "Nikelin". Krahas "Qemës", Drenica e zyrtarizoi edhe sulmuesin Isa Eminhaziri, i cili ka djersitur fanellën e Gjilanit dhe Feronikelit. Entuziast për kalim në skuadrën e Drenicës është shfaqur sulmuesi Eminhaziri, i



cili ka deklaruar: "Falënderoj kryesinë e klubit për besimin e madh të treguar ndaj meje, posaçërisht drejtorin sportiv Tahir Lushtaku, i cili bëri gjithçka që unë të jem pjesë e këtij klubi me traditë. Shpresoj se me ndihmën e shokëve të skuadrës do të bëjmë gjëra të mëdha në këtë sezon. Po ashtu falënderoj kryesinë e Gjilanit për korrektësinë që tregoi ndaj meje dhe 'Skifterat' që janë

supër tifozë. Për gjërat e tjera do të flas në fushë".

E ardhmja e Bylbyl Sokolit, në "mjegull"

KF Llapi me shumë bujë e transferoi trajnerin e mirënjohur Bylbyl Sokoli, por "Profa" mund të mos i prijë Llapit në edicionin 2018/2019 për shkak të dalimeve të mëdha konceptuale në

organizimin dhe drejtimin e këtij klubi. Sokoli nuk e ka përjashtuar mundësinë që të jetë trajner i Llapit, por kërkon t'i ketë duart e lira në punën e tij si trajner. Në anën tjetër, menjëherë pas kësaj mosmarrëveshje i ka "fërkuar" duart Ferizaj që ka konfirmuar interesimin për ish-trajnerin e vet. Ditët e ardhme do të mësohet se a do të jetë Sokoli trajner i Llapit apo i Ferizajt.

Trepça e Ligës së Parë rikthen Ibrahimimin

Futbollisti i njohur Fetah Ibrahimimi është rikthyer në skuadrën e Trepçës që bënë gara në Ligën e Parë të Kosovës në futboll. Ai beson se do t'i ndihmojë klubit për t'i arritur objektivat që ka në edicionin 2018/2019. "Pas dy vjetëve dhe përvojave që kalova, kthehem në shtëpi për ta ndihmuar klubin drejt objektivave të reja. Jam i lumtur që do t'i mbroj ngjyrat e qytetit tim dhe shpresoj se me përkrahjen e madhe të tifozëve të flaktë 'Torcida' t'i arrijmë qëllimet e klubit", ka thënë Ibrahimimi.

Drita në Luksemburg, sot përballet me Dudelangen

PRISHTINË, 25 KORRIK - Kampionia e Kosovës në futboll, Drita, pas eliminimit nga Liga e Kampioneve, sot (e enjte) nga ora 18:30 do të përballet me skuadrën e Dudelange në kuadër të Evropa Ligës. Kampionët e Kosovës të mërkurën në mëngjes kanë arritur në Luksemburg, kurse sot kërkojnë një rezultat pozitiv ndaj skuadrës së Dudelang në mënyrë që në ndeshjen e kthimit ta këtë më të lehtë kualifikimin. Skuadra tjetër që e përfaqësoi Kosovën në Evropa Ligë në këtë edicion ishte Prishtina, e cila u eliminua pas ekzekutimit të penall-



tive nga Fola Esch. Dy ndeshjet kishin përfunduar 0-0, në penallti Prishtina kishte tri herë rastin ta sigurojë kuali-

fikimin, por lojtarët "bardhekalter" nuk e kishin përqendrimin e duhur dhe në fund u eliminuan.

Austria mezi e mposhti Kosovën

PODGORICË, 25 KORRIK - Hendbollistët e Kombëtares U-20 të Kosovës të mërkurën e kanë luajtur ndeshjen e katërt në kuadër të kampionatit evropian që po mbahet në Podgoricë të Malit të Zi. Kosova në këtë ndeshje pësoi humbje nga Austria me rezultat 24:18, por paraqitja e djelmoshave të Kosovës ishte për çdo lëvdatë. Pas pjesës së parë rezultati ishte 14:9 në të mirë të Austrisë dhe

